



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË ARSIMIT  
PARAUNIVERSITAR

Nr. 4049/3 Prot.

Tiranë, më 31.7.2024

Lënda: Për ndjekje dhe kompetencë

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ✓  
Rruga "Naim Frashëri", Nr.37  
Tiranë

AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
Rruga "Aleksandër Moisiu", përballë IKV-së  
Tiranë

Në përgjigje të shkresës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar me nr. 533 prot., datë 21.06.2024, me lëndë: "Për miratimin e programeve mësimore për arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të orientuar me drejtim artistik" regjistruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), me nr. 4049 prot., datë 25.6.2024, bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin nr. 367, prot., datë 18.07.2024, "Për miratimin e programeve mësimore të kurrikulës artistike, të klasave të caktuara me drejtim artistik në arsimin bazë dhe programeve mësimore të arsimit të mesëm të lartë të orientuar me drejtim artistik".

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Gola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

## **KURRIKULA ARTISTIKE**

**Programet e degës: BALET**

**Specialiteti: Kërcimtar profesionist/balerinë**

**Për klasat: IV-IX**

**Tiranë, 2024**



## I. HYRJE

Baleti është një mënyrë e veçantë kërcimi në skenë nëpërmjet hapave të lëvizjes, muzikës, skenografisë dhe veshjeve, duke na treguar një histori, si dhe përndez imagjinatën e spektatorëve. Që të bësh lëvizje të përkryera, duhet të ushtrohemi gjatë e, megjithatë, baleti i zbavitë pa masë ata që e ushtrojnë dhe i mahnitë ata që e soditin. Baleti, së bashku me mësimin e llojeve të tjera të kërcimeve është objekt i një zhvillimi të specializuar e profesional, e cila kërkon një vemendje të posaçme edhe ndaj dokumentacionit bazë dhe përdorimit të tij në procesin konkret të artit të lëvizjes. Kjo e bën të domosdoshëm zhvillimin e dokumenteve kryesore sikurse është edhe kurrikula artistike bazuar në lëndë, ku do të përfshiheshin detyrimisht udhëzimet e nevojshme që nga përmbajtja koreografike, por edhe ajo muzikore, historike, duke u mbështetur në metodologjitë dhe vlerësimin e nxënësve në çdo nivel dhe cikël.

Në një kuadër të tillë, hartimi i kurrikulës artistike për mësuesit e degës “Balet” është menduar të jetë një udhërrëfyes i përgjithshëm për të orientuar lëndët teorike artistike, teorike - praktike dhe specialitetin e “Mjeshtërisë së kërcimit klasik” për çdo klasë, nivel dhe cikël shkollor për të bërë të mundur unifikimin dhe orientimin e të gjitha përmbajtjeve mësimore artistike përmes tematikave, metodologjive dhe vlerësimit në gjatë procesit mësimor.

## II. QËLLIMET E ARSIMIT, DEGA “BALET”

Kurrikula artistike në degën “Balet” ka si qëllim të formojë nxënësit në të dyja kulturat: kulturën teorike-artistike-profesionale dhe kulturën e përgjithshme, duke i përgatitur ata për sukses në tregun e punës dhe për një jetë të suksesshme në përgjithësi. Me një mision të qartë dhe një vizion përpara, ne synojmë të jemi një qendër e shquar e zhvillimit artistik dhe profesional të të rinjve në fushën e baletit.

Kjo degë kërkon të ofrojë një mësimdhënie të përshtatur sipas kërkesave por edhe duke iu ofruar interesave të nxënësve dhe aftësive apo talenteve në zhvillimin profesional të tyre në fushën e baletit/koreografisë/kërcimit. Kurrikula artistike në degën “Balet” krijon një mjedis mësimor frytdhënës, ku nxënësit mund të zhvillojnë pasionin e tyre për kërcimin duke eksploruar potencialin e tyre artistik.

Dega “Balet” dhe kurrikula e saj synon të sigurojë:

- Mundësi për të gjithë nxënësit për të zhvilluar kompetencat profesionale artistike të kërcimit, duke i bërë bazë njohurive, shprehive, qëndrimeve dhe vlerave të mjaftueshme për t'u integruar në punësim apo për të vazhduar studimet e tyre profesionale artistike në nivele më të avancuara.
- Mbështetje për të rritur disiplinën, aftësitë sipërmarrëse dhe për të përhapur vlerat estetike.
- Njohuri të thella të rregullave dhe praktikave të kërcimit profesional artistik, duke siguruar një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm për të studiuar dhe punuar në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- Mbështetje për zhvillimin psikologjik dhe fizik të nxënësve tanë, duke i përgatitur ata për sfidat e veprimtarive të tyre të ardhshme profesionale artistike.
- Mjedis mbështetës për të zhvilluar përgatitjen fizike dhe psikologjike, duke përgatitur nxënësit për të përballuar sfidat dhe rreziqet që mund të hasin në karrierën e tyre artistike.
- Përdorimi dhe njohuri mbi teknologjitë dhe metodologjitë bashkëkohore që lidhen me praktikën e kërcimit, për të përmirësuar nivelin e tyre artistik dhe profesional.
- Orientim dhe njohuri mbi rregullat dhe praktikën profesionale artistike të kërcimit, përfshirë sigurinë dhe standardet ndërkombëtare në mjedisin e punës.
- Promovimi i frymës së tolerancës dhe bashkëpunimit, duke u bazuar në përvojën e punës dhe ndarjen e përvojave në mes nxënësve.

Dega “Balet” dhe kurrikula e saj deri në fund të shkollimit kërkon të zhvillojë te nxënësit kompetenca të përgjithshme artistike. Në përfundim të arsimit të mesëm, nxënësit do të zotërojnë disa **kompetenca kryesore artistike**.

- **Komunikimi:** në mënyrë korrekte, mbi artin e kërcimit, duke shprehur mendimet dhe ndjenjat apo duke argumentuar qëndrimet e tyre për çështje të ndryshme profesionale artistike.

- ***Përdorimi i burimeve dhe teknikave:*** për të mbledhur dhe për të shfrytëzuar informacionet e nevojshme për zhvillimin e tyre personal dhe artistik.
- ***Zhvillimi i potencialit të brendshëm:*** në kërkim të zgjidhjeve të reja efektive dhe krijuese.
- ***Angazhimi dhe përkushtimi:*** fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin artistik, personal dhe shoqëror.
- ***Respektimi i rregullave dhe parimeve demokratike:*** për një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale dhe globale.
- ***Vetëkontrolli:*** gjatë zhvillimit të veprimtarive të tyre artistike, duke menaxhuar kohën dhe burimet në mënyrë efektive.
- ***Pjesëmarrja dhe vazhdimi i të nxënësve:*** duke shfaqur gadishmërinë dhe vullnetin për të mësuar gjatë gjithë jetës së tyre.
- ***Bashkëpunimi dhe respekti ndaj të tjerëve:*** duke bashkëpunuar aktivisht në arritjet e tyre si profesionistë artistikë, duke vlerësuar dhe respektuar kontributet e të tjerëve.
- ***Vlerësimi dhe vetëvlerësimi:*** duke i përdorur ato për të përmirësuar dhe për të avancuar në arritjet e tyre profesionale dhe artistike.

Dega “Balet” dhe kurrikula e saj deri në fund të shkollimit kërkon të zhvillojë te nxënësit kompetenca të përgjithshme artistike. Në përfundim të arsimit të mesëm, nxënësit do të zotërojnë disa ***kompetenca specifike artistike***.

- ***Ekzekutimi i klasës së baletit klasik:*** zhvillojnë njohuri të thella duke praktikuar ushtrimet përkatëse të levës, mesit të sallës dhe hedhjeve (Allegro saute), apo praktikimin e teknikës së puante për vajzat.
- ***Interpretimi i formave të ndryshme të kërcimit:*** të shkëputura nga baletet klasike si Pas des Deux, Pas de Trois, Pas de Six, Pas de Quatre, Pas d'Action, Marsh, Valse Mazurka, Polka, kërcime hungareze, spanjolle etj., duke i përshtatur ato sipas përmbajtjeve tematike të lëndëve të ndryshme të kërcimit.
- ***Interpretimi i teknikave dhe stileve të kërcimeve bashkëkohore:*** duke shfaqur njohuri të thella dhe aftësi në përdorimin e tyre.
- ***Interpretimi i valleve popullore:*** të trevave të ndryshme të Shqipërisë, duke i trajtuar ato me respekt dhe autenticitet.

- **Organizimi i procesit të të nxënit:** në një mënyrë të përshtatshme dhe efektive, duke përfshirë një formim të përgjithshëm profesional artistik dhe teoriko-praktik.
- **Klasifikimi i llojeve të kërcimeve:** duke i shqyrtuar ato në aspekte si lëvizje, periudha, përmbajtje, tema, stile, metoda, teknika, dhe të tjera.
- **Qëndrimi estetik:** ndaj veprave të ndryshme koreografike, duke i analizuar ato dhe duke i vlerësuar për karakteristikat dhe veçoritë e tyre.
- **Analiza dhe vlerësimi:** ndaj problemeve artistike, duke mbajtur një qëndrim profesional artistik.

#### **TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR SPECIALITIN “MJESHTËRI E KËRCIMIT”**

- Mjeshtëri e kërcimit klasik

#### **TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR SPECIALITETET SEKONDARE**

- Instrument Sekondar – Piano

#### **TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR LËNDËT TEORIKE ARTISTIKE**

- V.1. Solfezh

#### **TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR LËNDËT E TJERA ARTISTIKE**

- VI.1. Duet klasik
- VI.2. Repertor
- VI.3. Teknikë djem – Puante vajza
- VI.4. Balet Modern
- VI.5. Danc Historik
- VI.6. Vallja popullore

### III. UDHËZIME METODIKE TË PËRGJITSHME

#### III.1. PËR LËNDËN “MJESHTRI KËRCIMI KLASIK”

Kjo lëndë zhvillohet në grupe pavarësisht numrit të nxënësve (vajza dhe djem) me shoqërim muzikor në piano. Për arritjen e nivelit sa më optimal, nxënësi duhet të nxitet në sistematikën e tij në mënyrë rigorozë. Puna e mësuesit duhet të jetë kërkuese dhe e njëtrajtshme. Vëzhgimi psikologjik dhe emocional i nxënësit përbën një nga detyrat me të vështira të mësuesit. Puna për të rritur administrimin psiko-emocional duhet të bëhet gjatë gjithë vitit, me qëllim që të kemi rezultate sa më të larta.

Administrimi i orës së mësimit me intensitet dhe etapa të përcaktuara qartë do të rrisë shkallën e të nxënësve dhe rendimentin e orës së mësimit. Ndërthurja e kërkesave teknike me ato artistike do të bëjë orën e mësimit të pëlqyeshme për nxënësin. Puna e diferencuar, mbi bazën e mundësive fizike e intelektuale të çdo nxënësi, do të zhvillojë në mënyrë të drejtë e më të shpejtë nivelin e klasës. Mbi bazën e ecurisë së programit, mësuesi mund të avancojë në kërkesat e tij lidhur me programin, me nxënësit që e përvetësojnë atë më shpejt. Ushtrimet ose lëvizjet duhet t'i përgjigjen programit tematik.

Pavarësisht numrit të nxënësve në klasë në lëndët artistike profesionale, klasat punojnë të ndara në grupe (djem) (vajza) sepse programi i lëndëve artistike praktike për të dy gjinitë është i ndryshëm.

Kjo lëndë zhvillohet e ndarë në dy grupe pavarësisht numrit të nxënësve në klasë e shoqëruar me piano.

#### III.2. PËR LËNDËT E TJERA ARTISTIKE TË KËRCIMIT

**Duet klasik:** zhvillohet bazuar në elementet teknike të kërcimit duet dhe kombinacionet duhet të jenë të vendosura në logjikën e radhës, të ekzekutohen pa u nxituar së tepërmi, me qëllim që çdo shembull *padjerzhke* të kuptohet qartë. Përveç njohjeve dhe ekzekutimit të shembujve teknikë të *padjerzhkave*, partnerët, në çdo pjesë, duhet të dinë momentin se ku ndodhen, pozicionin e vet, që nga pozat organike në kombinim me

pozat e partnerëve, me shprehi estetike e skulpturale. Të gjitha kombinacionet ekzekutohen me njëren dhe me tjetren këmbë, gjithashtu, në anën e djathtë dhe në anën e majtë.

**Repertor:** zhvillohet në grupe pavarësisht numrit të nxënësve e shoqëruar me piano.

Përmes këtij programi fillon njohja e nxënësit me format e kërcimit të baleteve klasike. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet anës teknike dhe artistike të mësimit. Për arritjen e nivelit sa më optimal, nxënësi duhet të nxitet në sistematikën e tij. Puna e mësuesit duhet të jetë shumë kërkuese dhe e njëtrajtshme. Vëzhgimi psikologjik dhe emocional i nxënësit përbën një nga detyrat më të vështira të mësuesit. Puna për të rritur administrimin psiko- emocional duhet të bëhet gjatë gjithë vitit, që të kemi rezultate sa më të larta. Administrimi i mësimit me intensitet dhe etapa të përcaktuara qartë do të rrisin shkallën e të nxënësit dhe rendimentin e orës së mësimit. Ndërthurja e kërkesave teknike me ato artistike do të bëjë orën e mësimit të pëlqyeshme për nxënësin Puna e diferencuar, mbi bazën e mundësive fizike e intelektuale të çdo nxënësi, do të zhvillojë në mënyrë të drejtë e më të shpejtë nivelin e klasës. Mbi bazën e ecures së programit, mësuesi mund të avancojë në kërkesat e tij/saj lidhur me programin, në individë që e përvetësojnë atë më shpejt. Ushtrimet ose lëvizjet duhet t'i përgjigjen programit tematik.

**Teknikë Djem - Puante vajza:** zhvillohet në grupe pavarësisht numrit të nxënësve (vajza dhe djem) dhe shoqërohet me piano. Përmes këtij programi fillon njohja e nxënësit me format e me rolin e forcës, fleksibilitetit, shkathtësisë, koordinimit dhe artikulimit trupor në teknikën e kërcimit. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet anës teknike dhe artistike të mësimit. Për arritjen e nivelit sa më optimal, nxënësi duhet të nxitet në sistematikën e tij. Puna e mësuesit duhet të jetë shumë kërkuese dhe e njëtrajtshme. Vëzhgimi psikologjik dhe emocional i nxënësit përbën një nga detyrat më të vështira të mësuesit. Puna për të rritur administrimin psiko- emocional duhet të bëhet gjatë gjithë vitit, që të kemi rezultate sa më të larta. Administrimi i mësimit me intensitet dhe etapa të përcaktuara qartë do të rrisin shkallën e të nxënësit dhe rendimentin e orës së mësimit. Ndërthurja e kërkesave teknike me ato artistike do të bëjë orën e mësimit të pëlqyeshme për nxënësin Puna e diferencuar, mbi bazën e mundësive fizike e intelektuale të çdo nxënësi, do të zhvillojë në mënyrë të drejtë e më të shpejtë nivelin e klasës. Mbi bazën e ecures së programit, mësuesi mund të avancojë në kërkesat e tij/saj lidhur me programin, në individë që e përvetësojnë atë më shpejt. Ushtrimet ose lëvizjet duhet t'i përgjigjen programit.



**Baleti modern** - zhvillohet e ndarë në grupe pavarësisht numrit të nxënësve në klasë.

Nëpërmjet këtij programi nxënësi njihet me teknikën dhe zhvillimin e sistemit të kërcimit kontemporan. Nxënësi duhet të përvetësojë bazat e kërcimit modern, pozicionet e duarve , këmbëve e të trupit në tërësi. Ai duhet të rrisë teknikën, të koordinojë lëvizjet me frymëmarrjen e muzikën si dhe të arrijë të interpretojë me saktësi çdo lëvizje.

**Danci historik:** fillon me njohjen e nxënësit me kërcimet e shekujve të kaluar. Në fillim vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mësimi të vendosjes së trupit, këmbëve , kokës dhe duarve sipas stillit të kërkuar në kërcimit historik dhe mësimi të elementeve bazë të kërcimit historik. Mbas mësimi më vete të çdo lëvizje rekomandohet të lidhen 3-4 nga lëvizjet e përvetësuara në etyde në kohë muzikore 2/4, 3/4 dhe 4/4.

Përvetësimi i lëvizjeve bazë kërkon që më tej të vazhdohet me mësimin e lëvizjeve kryesore të kërcimeve që kanë dominuar në shekullin e XVI XVII, XVIII dhe XIX. Mbas mësimi të lëvizjeve kryesore të kërcimeve duhet të mësohet vendosja në çift dhe marrëdhënia që krijojnë partnerët gjatë kërcimit të çdo kërcimi për ta konkluduar këtë punë në mësimin e kërcimeve me figurat e duhura.

Gjatë kësaj pune rekomandohet që përveç shpjegimit teorik të lëvizjeve të flitet dhe rreth kostumeve, historisë së krijimit së secilit kërcim, kushtet shoqërore të periudhës dhe njëkohësisht të mund të shoqërohet me fragmente të literaturës

**Vallja popullore:** zhvillohet në grupe pavarësisht numrit të nxënësve e shoqëruar me piano ose fizarmonikë. Lënda “Valle popullore” për nxënësit e arsimit bazë është një nga lëndët më të rëndësishme për edukimin e nxënësve me shprehitë e valles sonë popullore dhe asaj të kultivuar skenike. Përvetësimi i shprehive plastike të valles sonë popullore është baza nga ku nxënësi do të interpretojë artin koreografik të kultivuar me frymë të theksuar kombëtare.

Nëpërmjet kësaj lënde, nxënësit jo vetëm që mësojnë morfologjinë e kërcimit popullor, por dhe përmbajtjen e pasur të traditës së popullit tonë që nëpërmjet valles ka ditur të shprehë botën e tij shpirtërore. Repertori i valles popullore përfshin valle tradicionale burimore dhe valle të përpunuara të Ansambllit Shtetëror të Këngëve dhe të Valleve Popullore, duke pasur parasysh vallet me leksik të kristalizuar si shembuj më të mirë të lëvizjes

**Shënim:** Pavarësisht numrit të nxënësve në klasë në lëndët artistike , klasat punojnë të ndara në grupe (djem) (vajza) sepse programi i lëndëve artistike praktike për të dy gjinitë është i ndryshëm.

Lënda e specialitetit dhe lëndët artistike të kërcimit ndahen në grupe edhe kur numri i nxënësve është më pak se katër, dhe në lëndët teoriko-artistike klasa ndahet në grupe kur është më shumë se 15 nxënës.

### III.3. PËR LËNDËT TEORIKE

Nëpërmjet programit të “Solfezhit” nxënësi njihet notat, përvetëson ritmet e thjeshta, të përbëra, të përziara, formon shkallët maxhore dhe minore, formon intervalet, dallon shenjat muzikore dhe shenjat dinamike, ndërton akordin dhe llojet e saj, njihet format muzikore dypjesëshe të thjeshta dhe tripjesëshe të thjeshta, njihet gjinitë e vogla muzikore, zhvillon veshin muzikor dhe sensin ritmik me anë të diktatit.

### IV. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi në shkollën artistike dega “Balet” është procesi gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet, mbi bazë të kritereve të caktuara, për të matur dhe për të vlerësuar të gjitha aspektet e procesit të *kryerjes së performancës artistike*, në kërcime të ndryshme. Vlerësimi i nxënësve është ndër komponentët më të rëndësishëm që tregon rezultatet e arritura të nxënësve të programit artistik. Ky vlerësim, përfshin gjykimin për arritjet artistike të nxënësve nëpërmjet performancës të programit. Qëllimi kryesor i vlerësimit në degën “Balet” është:

- Të sigurojë informacion të plotë për arritjet e nxënësit në shkollë dhe në fushën e tij të specialitetit.
- Të sigurojë informacion për shkallën e realizimit të rezultateve të pritshme të të mësuarit.
- Të motivojë nxënësit për arritje më të larta.

Për të realizuar qëllimin e tij vlerësimi duhet të jetë: a) i drejtë/i paanshëm/i ndershëm dhe b) i plotë/objektiv. *Paanshmëria/ndershmëria* e vlerësimit garantohet nga përdorimi i kritereve të unifikuara për vlerësimin e nxënësit (nivelet e përcaktuara e të miratuara të arritjeve).

*Plotësia e informacionit* për arritjet e nxënësit (artistike) garantohet nga format e ndryshme e të larmishme të të vlerësimit që përdoren dhe duhet të përdoren në shkollë (kryesisht përmes formimit e aftësive dhe shprehive teknike të kërcimit; zotërimin e elementeve teknik, elementeve artistik dhe emocional të lëvizjeve; zhvillimit të aftësisë interpretative dhe performimit artistik me individualitetin krijues, etj.)

Është detyrë e shkollës dhe e mësuesit që të garantojë kushtet e përshtatshme dhe motivuese të të mësuarit, duke e trajtuar procesin e vlerësimit si pjesë e procesit të të mësuarit dhe të mësimdhënies. Për këtë arsye, mësuesi duhet të planifikojë dhe të ndërtojë situata të mësuarit që u japin mundësi nxënësve të realizojnë objektivat e kurrikulës dhe ato personale në fushën e formimit artistik si dhe t'u japë atyre mundësinë për të demonstruar shkallën e arritjes së këtyre objektiveve.

Mësuesi, në përputhje me parimet themelore dhe kriteret e vlerësimit, siguron kriteret e vlerësimit, të cilët përcaktohen si të domosdoshëm për të gjykuar në lidhje me njohuritë apo performancën muzikore të nxënësve. Vlerësimi do të zhvillohet duke u bazuar në udhëzimet në fuqi për vlerësimin e nxënësve të shkollave artistike.

Lënda “Mjeshtëri e kërcimit klasik” nga klasa 4-9-të programi mësimor do të realizohet në dy periudha: Shtator - Janar dhe Shkurt - Qershor.

- Vlerësimi kryhet me notë nga mësuesi i specialitetit, si dhe përmes saxhove me komision.
- Çdo specialitet duhet të realizojë përgjatë çdo periudhe 1 saxho, dmth 2 saxho në vit.
- Nxënësit që fillojnë për herë të parë specialitetin në klasë të katërt (4), NUK zhvillojnë saxho në periudhën e parë (I). Në përfundim të klasës së katërt si një klasë përgatitore, vlerësimi bëhet pa notë , ku nxënësi i nënshtrohet konkursit me komision për të vazhduar klasën e 5( pestë) dhe nxënësit të cilët nuk përzgjidhen nga komisioni i jepet e drejta të rikthehen për tyë vazhduar klasën e pestë në shkollat ku kanë vendbanimin. Vlerësimi në këtë klasë do të jetë i vazhdueshëm nga mësuesi i specialitetit.
- Në fund të periudhës së (II) nxënësi zhvillon provimin përfundimtar (saxho) .

*Shënim:* Vlerësimi i nxënësve kryhet nga një komision, i cili përbëhet nga mësues të të njëjtit ekip lëndor. Vlerësimi i nxënësve në saxho bëhet nga komisioni ku është i përfshirë dhe mësuesi i lëndës , i cili ka të drejtën e një note. ***Në rast se nxënësi ka kontestim note , ngrihet një komision tjetër vlerësues .*** Në provimin përfundimtar (saxho) nxënësit e klasës së IX-të vlerësohen nga komisioni përzgjedhës. Në provimin përfundimtar të specialitetit (saxho) dhe provimit të formimit teorik praktik nxënësit e klasës së IX-të , vlerësohen nga komisioni përzgjedhës i IA-së.

*Disa kriteret matës që ky komision duhet të mbajë parasysh janë:*

- Impostimi
- Arritjet teknike dhe artistike në elementët e levës,
- Arritjet teknike dhe artistike në elementët mesit të sallës,
- Arritjet teknike dhe artistike në elementët allegro ,
- Arritjet teknike dhe artistike në elementët teknikë mashkullore
- Arritjet teknike dhe artistike në elementët në punat për vajzat
- Arritjet e teknikës dhe plastikës në kërcimin modern
- Aftësia në kërcimin me partner vajzë / djalë
- Aspekti fizik (pesha)
- Koordinimi
- Interpretimi/ muzikaliteti

## TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Dega: BALET

Lënda: Specialitet (Mjeshtëri e kërcimit klasik)

Klasat: 4-9

Tematikat klasa 4	Rezultatet e të nxënit
<b>HAPI</b>	<p><i>Nxënësi/ja në përfundim njeh, demonstroi, zbaton zotëron dhe realizon/interpreton performancën përmes elementeve të mëposhtëm:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Natyrën normale të hapave, kërcyes, ritmik, të kombinuar;</li><li>- Hapat në pullupals, të kombinuara;</li><li>- Hapat në thembra në vijë të drejtë, në diagonal;</li><li>- Hapat në lartësinë e gjurit me gishta të shtrira në vijë të drejtë, në diagonal;</li><li>- Vrapimin e lehtë, me gishta të shtrira të këmbës, me ngritje të gjurit lart, me kërcim lart, me hedhjen e këmbës para në 45°;</li><li>- Njohjen dhe ekzekutimin e marshit;</li><li>- Njohjen me hapin e polkës në vijë të drejtë, në diagonal;</li><li>- Realizimin e kërcimit Polka.</li></ul>
<b>LËVIZJET NË TOKË</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Lëvizjet në tokë që ndihmojnë në tëndosjen dhe çtëndosjen e muskujve;</li><li>- Lëvizjet që formojnë dhe ndihmojnë vivernan e këmbëve;</li><li>- Lëvizjet që forcojnë muskujt e barkut dhe ndihmojnë në krijimin e muskujve të shpinës;</li><li>- Lëvizjet që krijojnë elasticitet të rrëza e kofshës, sparkata, ballorja, palosja, shpalosja;</li></ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hapin bazë të kërcimit galop në vijë të drejtë, në diagonal dhe në rreth;</li> <li>- Pozicionin e I, II, III, IV, V të këmbëve;</li> <li>- Vendosjen e trupit me dy duar nga leva në pozicionin e I, II, III, IV dhe të V;</li> <li>- Vendosjen e duarve në pozicionin përgatitor në të I, II dhe të III-të;</li> <li>- Konceptin e këmbës së mbështetjes, së punës dhe shtrirjes së gishtave të këmbës.</li> </ul>
<b>LEVA</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-<i>Demi-plie</i> në pozicionin e I, II, V, III dhe të IV;</li> <li>-<i>Battement tendus</i> në pozicionin e I anash, përpara dhe mbrapa;</li> <li>-<i>Battement tendus</i> me <i>demi-plie</i> në pozicionin e I anash, përpara dhe mbrapa;</li> <li>-<i>Battement tendus</i> me <i>demi-plie</i> në pozicionin e II dhe të IV pa kaluar mbi këmbën tjetër;</li> <li>-<i>Battement tendus</i> duke vendosur thembrën në tokë në pozicionin e II-të;</li> <li>-<i>Battement tendus passes par terre</i>;</li> <li>-Mësimin e konceptit <i>en dehors</i> dhe <i>en dedans</i>;</li> <li>-<i>Demi-rond de jambe par terre en dehors</i> dhe <i>en dedans</i>;</li> <li>-<i>Rond de jambe par terre en dehors</i>;</li> <li>-<i>Rond de jambe par terre en dedans</i>;</li> <li>-<i>Temps sauté</i> në pozicionin e I, II dhe të V-të;</li> <li>-<i>Relevés</i> në gjysëm shputë në pozicionin e I, II dhe të V me këmbë të shtrira dhe me <i>-demi-plie</i>;</li> <li>-Njohjen me lëvizjen bazë të kërcimit Vals. Tempi që e shoqëron kërcimin Vals;</li> <li>-Ekzekutimin e lëvizjes në vijë të drejtë, në diagonal dhe në rreth</li> <li>-<i>Port de bras i I-rë</i>;</li> </ul>

	<p>-<i>Battement tendus jetes</i> nga pozicioni i I dhe i II përpara, anash dhe mbrapa;</p> <p>-Vendosjen e këmbës në <i>sur le cou-de-pied</i>;</p> <p>-<i>Battement frappes</i> përpara, anash dhe mbrapa;</p> <p>-<i>Battement tendus plie soutenus</i> nga pozicioni i I dhe i V përpara, anash dhe mbrapa;</p> <p>-<i>Preparacion për rond de jambe par terre en dehors dhe en dedans</i>;</p> <p>-<i>Battement fondu</i> përpara, anash dhe mbrapa me majën në tokë;</p> <p>-<i>Battement releve lent</i> në 45* përpara, anash dhe mbrapa;</p> <p>-<i>Battement releve lent</i> në 60* anash dhe mbrapa;</p> <p>-<i>Battement retire</i>;</p> <p>-<i>Grand battement jetes</i> nga pozicioni i I përpara, anash dhe mbrapa;</p> <p>-<i>Grand-plier</i> në pozicioni e I, II, III, IV dhe i V-të;</p> <p>-<i>Battement developpe</i> përpara dhe anash;</p> <p>-<i>Pas de bourree simple</i>;</p> <p>-<i>Port de bras</i> dhe përkulje e trupit (me dy duar nga leva).</p>
<b>Tematikat klasa 5</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<b>USHTRIMET NË LEVË</b>	<p><i>Nxënësi/ja në përfundim njeh, demonstroi, zbaton zotëron dhe realizon/interpretin performancën përmes elementeve të mëposhtëm:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pozicionet e këmbëve I, II, III, IV, V-të.</li> <li>- Pozicionet e krahëve, përgatitor I, II, III-të.</li> <li>- <i>Demi-plier</i> në pozicionin I, II, III, V, IV.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Battements tendus</i> nga pozicioni anash, përpara dhe mbrapa.</li> <li>- <i>Battements tendus</i> me <i>demi-plie</i> në pozicionin anash, përpara, mbrapa.</li> <li>- <i>Battements tendus</i> nga pozicioni i V-të anash, përpara, mbrapa.</li> <li>- <i>Battements tendus medemi-plie</i> në pozicionin e V-të anash, përpara, mbrapa.</li> <li>- <i>Battements tendus</i> duke vendosur thembrën në tokë në pozicionin II nga I dhe V-së.</li> <li>- <i>Battements tendus</i> me <i>demi-plie</i> në pozicionin II pa kaluar mbi këmbën tjetër dhe në IV pa kaluar dhe me kalim në këmbën tjetër nga I dhe V.</li> <li>- <i>Battements tendus passes pas terre</i>.</li> <li>- Mësimin e drejtimit <i>en dehors</i> dhe <i>en dedans</i>.</li> <li>- <i>Demirond de jambe par terre en dehors, en dedans</i>.</li> <li>- <i>Rond de jambe par terre en dehors, en dedans</i>.</li> <li>- <i>Port de bras</i> I dhe III.</li> <li>- <i>Battements tendus jetes (degages)</i>.</li> <li>- Pozicionin e këmbës në <i>sur le cou de pied</i> (pozicion i këmbës për battement fondu).</li> <li>- <i>Relevés</i> në gjysmë shputë në pozicionin I, II, V me këmbë të shtrira dhe në <i>demi plie</i>.</li> <li>- <i>Battements fondus</i> anash, para, mbrapa (në fillim mësohet me këmbën në tokë dhe më vonë në 45°).</li> <li>- <i>Battements tendus plie-soutenus</i> përpara, anash, mbrapa dhe me <i>releve</i> në gjysmë majë në pozicionin V.</li> <li>- <i>Preparasion</i> për <i>rond de jambe par terre en dehors, en dedans</i>.</li> </ul>
--	---



- Pozicionin e këmbës në *sur le cou de pied* përpara dhe mbrapa (vendosur për *battements frappes*).
- *Battements frappes* përpara, anash, mbrapa (në fillim me rrëshkitje në tokë, pastaj në 30°).
- *Battements soutenus* përpara, anash, mbrapa (fillimisht me këmbën në tokë dhe më vonë në 45°).
- *Petits battements sur le cou de pieds*. Goditje të njëjta me aksent përpara dhe mbrapa.
- *Battements frappes double* anash, përpara, e mbrapa (në fillim me majën në tokë më pas në 30°).
- *Battements releves lents* në 90° nga I dhe V përpara, anash, mbrapa.
- *Grand plies* në të I, II, III, V (pozicioni IV mësohet më vonë).
- *Grand battements jetes* nga I dhe V përpara, anash dhe mbrapa.
- *Battements retires*.
- *Battements developpes* përpara, anash dhe mbrapa, *passes* nëpër të gjitha pozicionet.
- *Rond de jambe en l'air en dehors dhe en dedans*.
- *Rond de jambe par terre en dehors dhe en dedans* në demi plie.
- Poza të vogla; *croise, efface ecarte* përpara dhe mbrapa *arabesque i II* në tokë dhe në *demi-plie*.
- Thyerjen e trupit mbrapa dhe anash me fytyrë nga leva.
- *Pas de bourree simple*.
- *Pas de bourree suivi* pa u spostuar.
- Gjysmë xhiro në të V mbi të dy këmbët duke ndryshuar këmbën në gjysmë shputë.

## MESI I SALLËS

*Nxënësi/ja në përfundim njeh, demonstroi, zbaton zotëron dhe realizon/interpretin performancën përmes elementeve të mëposhtëm:*

- Pozicionet e krahëve, përgatitor, I, II, III.
- *Demi-plie* në pozic. e I, II *en face* në të III, V, IV *en face* dhe *epaulement*.
- *Battendus tendus* nga pozicioni I dhe V përpara anash dhe mbrapa, me *demi-plie* e njëjta gjë, me *demi-plie* në pozicionin e II, IV me kalim dhe pa kalim *passes par terre*.
- *Battements tendus jetes (degages)*; nga pozicioni I në të gjitha drejtimet, me *demi-plie* në I dhe V në të gjitha drejtimet.
- *Demirond de jambe par terre en dehors e en dedans*.
- Preparacion për *rond de jambe par terre en dehors e en dedans*.
- *Grand plie* në pozic. e I dhe të II në të V *en face e epaulement*.
- *Battements frappes* - me majën në tokë në të gjitha drejtimet dhe në 30°.
- *Battements frappes doubles* me majën në tokë në të gjitha drejtimet dhe në 30°.
- Pozicioni *epaulement croise dhe efface*.
- Bazat e pozave; *croise, efface, ecarte* përpara dhe mbrapa dhe në *arabesque* I, II, III.
- *Battements tendus plie-soutenus* në të gjitha drejtimet.
- *Battements fondus*; me majën në tokë në të gjitha drejtimet në 45° në të gjitha drejtimet.
- *Battements soutenus en face* me majën në tokë në të gjitha drejtimet.
- *Petits battements sur le cou de pied* me goditje të njëjtë dhe me aksent përpara dhe mbrapa.
- *Battements releve lents* në të gjitha drejtimet.
- *Battements developpes* në të gjitha drejtimet.

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Grands battements jetes</i> nga pozicioni I dhe V në të gjitha drejtimet.</li> <li>- <i>Rond de jambe en l'air en dehors dhe en dedans.</i></li> <li>- <i>Port de bras</i> pa lëvizur trupin <i>en face</i> dhe <i>epaulement</i>.</li> <li>- <i>Port de bras</i> I, II, III.</li> <li>- <i>Relevés</i> në gjysmë shputë në pozicionin I, I, V me <i>demi-plie</i> dhe këmbë të shtrirë.</li> <li>- <i>Pas de bourree simple</i> me ndërrim këmbë, <i>en face</i>.</li> <li>- <i>Pas de bourree suivi en face</i> në gjysmë shputë në vend dhe duke lëvizur anash.</li> <li>- Xhiro mbi të dy këmbët në pozicionin V në vend.</li> <li>- Poza të vogla: <i>croise, efface, ecarte</i>, përpara dhe mbrapa dhe në <i>arabesque</i> I, II, III me majën në tokë dhe këmbën tjetër të shtrirë dhe në <i>demi-plie</i>.</li> <li>- <i>Temps lie par terre</i> përpara dhe mbrapa.</li> <li>- Hapin e polkës.</li> <li>- Hapin e polonës.</li> </ul>
<b>HEDHJET</b>	<p><i>Nxënësi/ja në përfundim njeh, demonstroi, zbaton, zotëron dhe realizon/interpretin performancën përmes elementeve të mëposhtëm:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Temps sautés</i> në pozicionin I, II, dhe V-të.</li> <li>- <i>Changements de pied.</i></li> <li>- <i>Echappe</i> në pozicionin II.</li> <li>- <i>Assemble</i> anash.</li> <li>- <i>Pas de glissade</i> anash.</li> <li>- <i>Pas balance.</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Sissonne simple sur le cou de pied.</i></li> <li>- <i>Sissonne fermee anash.</i></li> <li>- <i>Petit pas chasse en face</i> përpara.</li> <li>- <i>Pas de basque</i> përpara( tip vals i përpara-forma skenike).</li> </ul>
<b>PUANTET</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Relevés</i> në pozicionin I,II,V-të.</li> <li>- <i>Pas echappe</i> në pozicionin II nga pozicioni I dhe V.</li> <li>- <i>Pas assemble soutenu en face</i> .</li> <li>- <i>Pas de bourree simple en face</i> (me ndërrim këmbësh).</li> <li>- <i>Pas de bourree suivi en face</i> në vend dhe me spostim.</li> <li>- <i>Pas couru en face</i> në pozicionin I përpara dhe mbrapa.</li> <li>- <i>Pas de glissade anash.</i></li> </ul>
<b>Tematikat klasa 6</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<b>USHTRIMET NË LEVË</b>	<p><i>Nxënësi/ja në përfundim njeh, demonstroi, zbaton zotëron dhe realizon/interpreton performancën përmes elementeve të mëposhtëm:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Grand plies me port de bras</i> (punojnë duart pa trupin).</li> <li>- <i>Battements tendus</i> : <ul style="list-style-type: none"> <li>a) <i>doubles</i> duke ulur dy herë thembrën në pozicionin II,</li> <li>b) në të gjitha pozat e vogla e të mëdha,</li> <li>c) <i>pour le pied.</i></li> </ul> </li> <li>- <i>Battements tendus jete: en cloche</i> (balancoire), në të gjitha pozat e vogla e të mëdha.</li> </ul>

- *Demi rond de jambe* në 45\* *en dehors*, *en dedans* në shputë të këmbës dhe në gjysmë shputë.
- *Rond de jambe* në 45\* *en dehors* , *en dedans* në të gjithë shputën e këmbës.
- *Battements fondus* :
  - a) në të gjitha pozat dhe shputën e këmbës me majën në tokë dhe 45\*,
  - b) *en face* dhe nëpër poza në gjysmë shputë.
  - c) *me plie releve* në gjithë shputën dhe gjysmë maje dhe në poza,
  - d) *doubles* në shputë dhe gjysmë maje.
- *Battements soutenus* në shputë dhe në gjysmë shputë në të gjitha drejtimet *en face* dhe në poza me majën në tokë dhe në 45\*.
- *Battements frappe* në të gjitha drejtimet në gjysmë maje.
- *Battements frappe doubles* në të gjitha drejtimet në gjysmë shputë.
- *Petits battements sur le cou de pied* në gjysmë shputë.
- *Flic* para dhe mbrapa në shputë të këmbës dhe gjysmë shputë.
- *Pas coupe* në shputë të këmbës dhe në gjysmë shputë.
- *Pas tombe* në vend me këmbën të ngritur në *sur le cou de pied*.
- *Rond de jambe an l'air en dehors dhe en dedans* në gjysmë shputë.
- *Petit temps releve en dehors dhe en dedans* në shputë të këmbës dhe gjysmë shputë.
- *Battements releve lents* në 90\* dhe *battements releve developpes* në pozat *croisee*, *efface*, *ecarte*, para dhe mbrapa , *attitude efface dhe croisee* dhe në *arabesque II*.
- *Demi rond de jambe dhe grand rond de jambe developpes en dehors dhe en dedans*.

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Grand battements jetes: në të gjitha pozat, pointes në të gjitha drejtimet en face dhe në poza.</i></li> <li>- <i>Port de bras bëhet me këmbë të shtrirë, me majën para, anash dhe mbrapa; port de bras III bëhet në të njëjtën pozicion me këmbën e mbështetjes në demi-plie.</i></li> <li>- <i>Releve në gjysmë shputë në pozicionin e IV pastaj me këmbën e punës në sur le cou de pied dhe në 45*.</i></li> <li>- <i>Gjysmë rrotullim en dehors dhe en dedans mbi të dyja këmbët, në V duke ndryshuar këmbë dhe duke filluar si me demi-plie dhe me gjunjë të shtrirë.</i></li> <li>- <i>Kthesë fouettë en dehors dhe en dedans me ¼, ½ e rrethit nga poza në pozë me majën në tokë dhe këmba e punës e shtrirë ose në demi-plie.</i></li> <li>- <i>Preparacionë për pirouettes në pozicionin cou de pied en dehors dhe en dedans nga pozicioni V.</i></li> </ul>
<p style="text-align: center;"><b>USHTRIMET NË MESIN E SALLËS</b></p>	<p><i>Nxënësi/ja në përfundim njeh, demonstroi, zbaton zotëron dhe realizon/interpretin performancën përmes elementeve të mëposhtëm:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Grand plie në pozicionin IV en face dhe epaulement croisee dhe efface.</i></li> <li>- <i>Battements tendus: në poza të vogla e të mëdha, doubles në pozicionin II.</i></li> <li>- <i>Battements tendus jetes (degage): në poza të vogla e të mëdha, piques en face dhe në poza të vogla e të mëdha.</i></li> <li>- <i>Rond de jambe par terre en dehors dhe en dedans në demi-plie</i></li> <li>- <i>Demi rond de jambe në 45* en dehors dhe en dedans.</i></li> <li>- <i>Battements fondus:</i></li> </ul>

	<p>a) në poza të vogla e të mëdha me majën në tokë dhe në 45*,</p> <p>b) <i>me plie dhe releve en face</i> dhe në poza,</p> <p>c) <i>doubles en face</i>.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Battements soutenus en face</i> në poza të vogla e të mëdha me majën në tokë dhe në 45* në maje të gishtave.</li> <li>- <i>Petits pas jetës</i> në gjysmë shputë para, mbrapa dhe anash (<i>piques</i>).</li> <li>- <i>Battements frappe</i> në poza të vogla e të mëdha me majën në tokë dhe në 30*.</li> <li>- <i>Battements frappe doubles</i> në poza të vogla e të mëdha me majën në tokë dhe në 30*.</li> <li>- <i>Petits battements sur le cou de pied</i> me të njëjtën aksent para dhe mbrapa <i>en face dhe me epaulement</i>.</li> <li>- <i>Filc</i> para dhe mbrapa në të gjithë shputën e këmbës.</li> <li>- <i>Pas coupe</i> në të gjithë shputën e këmbës.</li> <li>- <i>Pas tombe</i> në vend me këmbën tjetër në <i>cou de pied</i>.</li> <li>- <i>Ronds de jambe en l'air en dehors dhe en dedans</i>.</li> <li>- <i>Petits temps releve en dehors dhe en dedans</i>.</li> <li>- <i>Battements releve lents dhe battements developpes en face</i> dhe në pozat <i>croisee, efface, ecarte</i> para dhe mbrapa, <i>attitude efface dhe croisee</i> dhe në <i>arabesque I, II, III</i>.</li> <li>- <i>Battements developpes passes en face dhe në poza</i>.</li> <li>- <i>Demi- rond de jambe developpes en dehors dhe en dedans en face</i>.</li> <li>- <i>Grand battements jetes dhe grand battements jetes pointes</i> në të gjitha pozat.</li> <li>- <i>Port de bras</i> me thyerje të trupit anash.</li> </ul>
--	---

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Port de bras</i> të ndryshme me tërheqje dhe thyerje të trupit me një këmbë të shtrirë përpara dhe mbrapa.</li> <li>- <i>Port de bras IV dhe V-të</i> në pozicionin <i>V</i>.</li> <li>- <i>Poza në arabesque IV</i> me majën në tokë.</li> <li>- <i>Temps lie par terre</i> me <i>port de bras</i> (thyejmë pak trupin para dhe mbrapa).</li> <li>- <i>Relevés</i> në gjysmë shputë: në pozicionin e <i>IV croisee dhe efface</i>, me një këmbë në <i>sur le cou de pied</i> ose të ngritur në 45* në të gjitha drejtimet.</li> <li>- <i>Pas de bourre de cote</i> me majën në tokë dhe në 45*.</li> <li>- <i>Pas de bourree ballotte</i> në <i>efface dhe croisee</i> me majën në tokë dhe në 45*.</li> <li>- Gjysmë kthesë mbi të dyja këmbët në pozicionin e <i>V-të</i> me ndryshim këmbësh <i>en dehors dhe en dedans</i> fillimisht me gjunjë të shtrira dhe në <i>demi-plie</i>.</li> <li>- <i>Preparacionë për pirouettes sur le cou de pied en dehors dhe en dedans</i> nga pozicioni <i>V, IV, II</i>.</li> <li>- <i>Pirouettes en dehors dhe en dedans</i> nga pozicioni <i>V, IV, II</i> e mbaruar në pozicionin <i>V dhe IV</i>.</li> </ul>
<b>HEDHJET</b>	<p><i>Nxënësi/ja në përfundim njeh, demonstron, zbaton zotëron dhe realizon/interpreton performancën përmes elementeve të mëposhtëm:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Temps saute</i> në pozicioni <i>IV</i>.</li> <li>- <i>Grands changements de pied</i>.</li> <li>- <i>Petits changements de pied</i></li> <li>- <i>Changements de pied en tournant</i> me ¼, ½ e rrethit (për meshkuj).</li> </ul>



- *Grand pas echappe* në pozicioni II dhe IV *croisee dhe efface*.
- *Petits pas echappe* në pozicioni e II dhe IV në *croisee dhe efface*.
- *Pas echappe* në pozicioni II dhe IV mbaruar mbi një këmbë dhe tjetra *en face* para dhe mbrapa.
- *Pas assemble en face* para dhe mbrapa dhe me vonë në *croisee dhe efface*.
- *Doubles pas assemble*.
- *Sissonne simple en face* dhe në poza të vogla.
- *Petits pas jete en face* dhe me vonë mbaruar në poza të vogla.
- *Pas glissade* në të gjitha drejtimet *en face* dhe në poza të vogla.
- *Pas coupe*.
- *Petits pas chasse* në të gjitha drejtimet *en face* dhe në poza .
- *Pas de chat*.
- *Temps leve* me këmbën në *sur le cou de pied* ( fakultative).
- *Sissonne ouverte pas developpes* në 45\* para, anash, *en face*.
- *Sissonne fermee* në të gjitha drejtimet dhe në poza të vogla.
- *Sissonne ouvert* në të gjitha drejtimet *en face*.
- *Pas emboite sur le cou de pied* para dhe në 45\* në vend dhe e spostuar.
- *Pas de basque* para dhe mbrapa.
- *Pas de basque en tournant* në ¼ e rrethit.
- *Pas balance en tournant* në ¼ e rrethit.
- *Temps leve* në *arabesque I dhe II* (*Sissonne skenike*).

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Tour en l'air</i> ( për meshkuj).</li> </ul>
<p style="text-align: center;"><b>USHTRIMET NË PUANTE</b></p>	<p><i>Nxënësi/ja në përfundim njeh, demonstroi, zbaton zotëron dhe realizon/interpretin performancën përmes elementeve të mëposhtëm:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Releve</i> në pozicionin <i>IV en face, croisee dhe efface</i>.</li> <li>- <i>Pas echappe</i> në pozicionin <i>IV croisee dhe efface</i>.</li> <li>- <i>Pas echappe</i> në pozicionin <i>II dhe IV</i> e mbaruar mbi një këmbë dhe tjetra në pozicionin <i>cou de pied</i> para dhe mbrapa.</li> <li>- <i>Pas assemble soutenu</i> para, anash dhe mbrapa <i>en face dhe</i> në poza.</li> <li>- <i>Pas de bourre simple</i> ( me ndërrim këmbësh) e mbaruar në poza të vogla.</li> <li>- <i>Pas de bourree de cote</i>.</li> <li>- <i>Pas de bourree ballotte in croisee suivi en face</i> në poza të vogla e të mëdha duke levizur anash, para dhe mbrapa.</li> <li>- <i>Pas de bourree siuvi en tournant</i>.</li> <li>- <i>Pas couru</i> para dhe mbrapa <i>en face dhe epaulement</i>.</li> <li>- <i>Pas glissade</i> para, anash, mbrapa, <i>en face, epaulement e</i> poza.</li> <li>- <i>Temps lie par terre</i> para dhe mbrapa.</li> <li>- <i>Sissonne simple en face, epaulement dhe</i> poza (releve retire).</li> <li>- <i>Sus – sous</i> në poza të vogla e të mëdha.</li> <li>- Gjysmë kthesë dhe kthesë e plotë në pozicionin <i>V</i>.</li> <li>- <i>Petits pas jete</i> para, anash dhe mbrapa me këmbën tjetër në <i>sur le cou de pied</i>.</li> <li>- <i>Pas coupe – balloëë</i> duke e hapur këmbën anash.</li> </ul>

Tematikat klasa 7	Rezultatet e të nxënit
<p style="text-align: center;"><b>USHTRIME NË LEVË</b></p>	<p><i>Nxënësi/ja në përfundim njeh, demonstroi, zbaton zotëron dhe realizon/interpretin performancën përmes elementeve të mëposhtëm:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Battements tendus pour battérie</i> nga pozicioni IV në V-së pa e shtrirë majën në të dytin.</li> <li>- <i>Demi-rond</i> dhe <i>rond de jambe</i> në 45° <i>en dehors</i> dhe <i>en dedans</i> në gjysmë majë dhe në <i>demi-plie</i>.</li> <li>- <i>Battements fondus</i>: <ul style="list-style-type: none"> <li>a) <i>doubles</i> në gjysmë majë;</li> <li>b) me <i>plie-releve</i> dhe <i>demi-rond de jambe</i> në 45° <i>en face</i> dhe nga poza në pozë;</li> <li>c) me <i>plie releve</i> dhe <i>rond de jambe</i> në 90° <i>en face</i> në shputë të këmbës dhe në gjysmë majë.</li> </ul> </li> <li>- <i>Battements soutenus</i> në 90° në të gjitha drejtimet <i>en face</i> dhe në poza në gjysmë majë.</li> <li>- <i>Battements frappes</i>: në të gjitha pozat me majën në tokë në 30° mbi shputën e këmbës dhe në gjysmë majë e mbaruar në <i>demi-plie</i>, me <i>releve</i> në gjysmë majë.</li> <li>- <i>Battements frappes doubles</i>: <ul style="list-style-type: none"> <li>a) në të gjitha pozat me majën në tokë dhe në 30° mbi shputën e këmbës dhe në gjysmë majë;</li> <li>b) me <i>releve</i> në gjysmë majë në të gjitha drejtimet e mbaruar në <i>demi-plie</i></li> </ul> </li> <li>- <i>Petits battements sur le cou de pied</i> me <i>plie-releve</i> mbi shputën e këmbës dhe në gjysmë majë me theksin përpara dhe mbrapa.</li> <li>- <i>Flic-flac en face</i>.</li> </ul>

- *Pas tombe*: e spostuar me këmbën që punon në *sur le cou de pied*, me majën në tokë dhe në  $45^0$ , në vënd me gjysmë kthesë *en dehors* dhe *en dedans*, këmba që punon në *cou de pied*.
- *Ronds de jambe en l'air en dehors* dhe *en dedans* e mbaruar në *demi-plie*.
- *Battements de cuisse*.
- *Battements releve lents* dhe *battements developpes* në të gjitha drejtimet en face dhe në poza në gjysmë majë dhe në *demi-plie*.
- *Relevés* në gjysmë majë me këmbën në  $90^0$  në të gjitha drejtimet.
- *Demi-rond de jambe developpe en dehors* dhe *en dedans* në *demi-plie*.
- *Grands battements jetes passes par terre* e mbaruar me majën të shtrirë përpara dhe mbrapa.
- *Port de bras: port de bras III* me këmbën të shtrirë mbrapa dhe *demi-plie* e thellë pa kaluar të këmba tjetër dhe më pas me kalim, *port de bras V* me majën të shtrirë përpara dhe mbrapa.
- Rrotullim mbi dy këmbë në pozicionin V me ndërrim këmbë duke filluar me këmbën e shtrirë dhe me *demi-plie*.
- *Soutenus en tournant en dehors* dhe *en dedans* me  $\frac{1}{2}$  rrotullimi dhe një rrotullim i plotë duke filluar me majën në tokë dhe në  $45^0$ .
- $\frac{1}{2}$  rrotullimi mbi një këmbë *en dehors* dhe *en dedans*: me këmbën që punon lart në *sur le cou de pied*, me këmbën në tokë në shputë të këmbës dhe në gjysmë majë.
- *Pirouettes* në pozicionin e V *en dehors* dhe *en dedans*.

## MESI I SALLËS

*Nxënësi/ja në përfundim njih, demonstron, zbaton zotëron dhe realizon/interpretin performancën përmes elementeve të mëposhtëm:*

- *Grand plies me port de bras* (punojnë vetëm duart pa trupin).
- *Battements tendus en tournant en dehors dhe en dedans* me 1/8 e rrethit.
- *Battements tendus jete (degages) balancoire en face* dhe në poza.
- *Demi-rond de jambe* në 45<sup>0</sup> *en dehors* dhe *en dedans* në gjysmë majë dhe në *demi-plie*.
- *Rond de jambe* në 45<sup>0</sup> *en dehors* dhe *en dedans* në shputë të këmbës.
- *Battements fondus*: në gjysmë majë *en face* dhe në poza, me *plie-releve* dhe *demi rond de jambe* në 45<sup>0</sup> *en face* në shputë të këmbës dhe në gjysmë majë, *doubles* në shputë të këmbës dhe në gjysmë majë *en face* dhe në poza, në 90<sup>0</sup> *en face* dhe në poza në shputë të këmbës.
- *Battements soutenus* në 90<sup>0</sup> grad *en face* dhe në poza në shputë të këmbës.
- *Battements frappes*: në gjysmë majë, e mbaruar në *demi-plie* me *releve* në gjysmë majë.
- *Battements frappes doubles*: në gjysmë majë, e mbaruar në *demi-plie en face* dhe në poza, me *relve* në gjysmë majë.
